

STATUTI I SHOQËRISE ME PERGJËGJËSI TË KUFIZUAR

“Just travel” Sh.p.k.

Sot, më datë 10/09/2021, personat e mëposhtëm:

1. Znj. Rudina Xhunga, shtetase shqiptare, e bija e Engjellit, lindur më 22/06/1972 në Vlore, banuese në Tirane në adresën Sheshi Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 18, Ap.22, Trane mbajtës i letërnjoftimit (karte identiteti) me nr. 035632278 dhe nr. Personal H25622118R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe

2. Znj. Irma Dudushi, shtetase shqiptare, e bija e Panajotit, lindur më 18/04/1980 në Korce, banuese në Tirane në adresën: Rruga Brigada VIII, hyrja 2, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit (karte identiteti) me nr. 035234433, dhe nr. Personal I05418172M madhere e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në perputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” dhe me legjisacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, vendosi të themelojë Shoqërine tregtare të emertuar **“Just travel” Sh.p.k.**

KAPITULLI I

THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1

Themeli, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise është **“Just travel” Sh.p.k.**

Shoqeria **“Just travel” Sh.p.k.** eshte një person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” (me pas referuar si “ Ligji Tregtar”) ne formen e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar. (Sh.P.K).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare te Biznesit (me pas referuar si “QKB”) ne perputhje me kushtet dhe proceduwart e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet per gjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.



Ortaket e Shoqerise do te jene perjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 2

Selia

Shoqeria do te kete seline e saj ne adresen e me poshtme:

Rruga Tish Daija, Kopleksi “Kika 2”, Shkalla nr.8, Njesia Administrative nr.5, Zona kadastrale 8260, Tiranë, Shqipëri.

Me vendimin te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, Shoqeria mund te çele dege dhe /ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

Neni 3


Objekti

Shoqeria ka per objekt kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprim apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar.

Me konkretisht por pa u kufizuar ne to, shoqeria ka per objekt:

Agjenci turistike, tour operator, prerje biletash per avion, per transport detar dhe rrugor, organizimi i tureve turistike brenda dhe jashte vendit, veprimtaria financiare e kembimeve valutore exchange, sherbime transporti, kurse trainimi per agjent udhetimi, siguracione, agjent imobilar, ushtrim i veprimtarise te ndermjetesimit ne sigurine si agjent, pjesemarrje ne projekte te ndryshme.

Shoqëria mundet gjithashtu të ushtrojë cdo lloj tjeter biznesi apo aktiviteti të ligjshëm dhe/ose mund të angazhohet në cdo veprimtari të ligjshme ose aktivitet te lejueshëm nga legjislacioni shqiptar në fuqi për një shoqëri me perjegjësi të kufizuar, i cili here pas here mund të ndryshohet në përputhje me dispozitat ligjore të këtij Statuti si dhe të ligjit të zbatueshëm.



Te gjitha këto veprimitari të lartpermendura duhet të kryhen brenda kufijve dhe sipas dispozitave ligjore që rregullojnë ushtrimin e tyre.

Ortakët e Shoqërisë, deklarojnë dhe garantojnë se gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit tregtar të Shoqërise, ata nuk do të ndërmarrin, themelojnë, kryejnë apo ushtrojnë asnjë veprimitari tjetër private të njëjtë apo të ngjashme me objektin e aktivitetit të Shoqërisë e cila mund t'i shkaktojë konkurencë Shoqërisë apo mund të dëmtojë interesat e kësaj të fundit.

Neni 4

Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI II

KAPITALI – KUOTAT


Neni 5

Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 10.000 leke (Dhjete mijë leke). Kapitali themeltar perbehet nga 2 (dy) kuota me vlere 5100 Leke (pese mijë e njeqind) dhe 4900 Leke (kater mijë e nenteqind), dhe eshte paguar e zoterohet teresisht nga ortaket e shoqerise, perkatesisht 51% te kuotave, **Znj. Rudina Xhunga** dhe 49% te kuotave **Znj. Irma Dudushi**.

5.2 Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treat per humbjen qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

5.3 Kapitali Themeltar mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.



Neni 6
Kuotat
Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

- 6.1 Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote.
- 6.2 Pronesa mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratorit (“ Regjistri i Ortakeve”).
- 6.3 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem : (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotave qe i perkasin cdo Ortaku ; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

Neni 7
Transferimi i Kuotave

- 7.1 Kuotat jane lirisht te transferueshme nepermjet trasheqimise apo ndermjet Ortakeve ekzistues.
- 7.2 Kalimi i te drejtave te pronesise, venia peng, barre apo çdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat do te kerkoste, ne menyre qe te prodhoje efekt, miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila vendos me shumice te thjeshte.
- 7.3 Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi nje numer kuotash ne perpjestim me pjesemarjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesio te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me procedure ne vijim.
- 7.4 Nese nje ortak ka per qellim te transferoje te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftojte me shkrim Administratorin per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuotat dhe kushtet esenciale te transferimit.




- 7.5 Administratori, Brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar – do te informoje me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.6 Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerje, Brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratorit per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratorin nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
- Administratori Brenda 10 (dhjete) diteve nga marja e ketij njoftimi do te njoftoje me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.7 Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes, ata do te blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.8 Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak sipas nenit 7.6 me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'ia transferoje keto kuota personit/ave te percaktuar.
- 7.9 Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftimin per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuotat object transferimi Brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit te percaktuar nga neni 7.6 me siper.
- 7.10 Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshe i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit

- 8.1 Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji.
- 8.2 Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtojne te drejtat e tyre te parablerjes Brenda 20 (njezet) diteve, atehere ata do t'i blejen keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.
- 8.3 Kuotat e reja qe do te shlyhen si me pare ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerine Tregtare.



Neni 9

Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Kapitali mund te zvogelohet, me bendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

KAPITULLI III


ORGANET E SHOQERISE

Neni 10

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

10.1 Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, vec kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Staturi, merr vendime per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se sherblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- h. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- i. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- k. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l. miratimin e rregullave te zbatueshme proceduriale te mbledhjeve te saj;
- m. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te ketij Statuti.



10.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interest e Shoqerise Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.


10.3 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vandin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacioni, po ashtu dhe rendi I dites, dhe duhet t'u njoftohet te gjithe Ortakeve jo me pak se 7 (shtate) dite perpara mbledhjes. Rendi I dites I njoftuar si me siper duhet te permbane edhe vendimet e propozuara per cdo ceshqje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutut, teksti duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

10.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratori dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket

10.5 Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjeter apo nga nje person I trete I ndryshem nga Administratori, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njeqit rend dite.

10.6 Ne rastin e vendimeve te zakonshme, Asamblese se Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ose te perfaquesuar Ortaket qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar. Ne keto raste Asamblese se Pergjithshme e Ortakeve do te marre vendime me shumicen e votive te kapitalit pjesemarres, vec kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregatr dhe/ose ky Statut. Per ceshqje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, si ndryshimi I Statutit, zmadhimi ose zvogelimi I kapitalit, shperndarja e fitimit, ristrukturimi dhe prishja e Shoqerise, Asamblese se Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ose te perfaquesuar Ortaket qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjete perqind) te kapitalit te regjistruar dhe do te marre vendime me $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e votive te kapitalit pjesemarres.



Nese Asamblese se Pergjithshme e Ortakeve nuk mund te mblidhet per shkak te mungese se kuorumi, Asambleja mblidhet perseri Brenda 30 diteve me te njejtin rend dite.

10.7 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njojur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi I Ortakut te interesuar / perkates.

10.8 Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratori eshte perjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

Neni 11

Organi Administrues/Administratori

11.1 Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5(pese) vjet, me te drejte ri emrimi.

Znj. Irma Dudushi, shtetase shqiptare, e bija e Panajotit, lindur më 18/04/1980 në Korce, banuese në Tirane në adresën: Rruga Brigada VIII, hyrja 2, mbajtës i letërnjofimit (karte identiteti) me nr. 035234433, dhe nr. Personal I05418172M madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, caktohet Adminstratore e pare e shoqerise me mandat 5 vjecar.

11.2 Administratori do te :

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesoje Shoqerine
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumentave kontabel;
- (iv) perqatisse dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratimin, se bashku me propozimet per shperndarjene fitimeve;
- (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;



- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje zbatimin e pllitikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performance e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Neni 12

Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13

Viti finanziar

Viti finanziar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare finanziar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Registrin Tregtar.

Neni 14

Rezerva Ligjore



Shoqeria do te kaloje ne fondin rezevre te detyrueshem te pakten 5% (pesë perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezevre te arrije vleren e barabarte me 10 perqind te kapitalit themeltar.

Neni 15
Dividentet

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton Shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

KAPITULLI V
PRISHJA-LIKUIDIMI

Neni 16
Prishja e Shoquerise


Shoqeria prishet (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimitari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsyte te tjera te parashikuara ne ligj.

Neni 17
Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoquerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 18
Dispozita Perfundimtare

18.1 Per te gjitha çeshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.




18.2 Konfliktet ne lidhje ne kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ku Shoqeria ka seline e saj.

18.3 Me qellim shhangien e çdo paqartesie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose çdo funksionari nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

18.4 Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe

ORTAKET THEMELUES

Znj. Rudina Xhunga



Znj. Irma Dudushi

